

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "Global AlbTreg" SH.P.K.

Sot, më datë 04.11.2024

Ne, nënshkruesit e mëposhtëm:

- Z. Lavdrim Tufa**, shtetas shqiptar, lindur më 28-10-1976, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Kartës së ID me nr. 033458731, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- Z. Adriatik Mino**, shtetas shqiptar, lindur më 02-11-1979, në Tepelenë, Shqipëri, mbajtës i Pasaportës me nr. BA2802201, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- Z. Nevzad Osmani**, shtetas kosovar, lindur më 11-10-1960, në Knjazhevac, mbajtës i Pasaportës me nr. P02046663, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), dhe Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kemi vendosur të themelojmë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Global AlbTreg**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1: EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Global AlbTreg**" Sh.p.k.

NENI 2: SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga Ndre Mjeda, Ndërtesa nr. 31, Hyrja nr. 2, Kodi Postar 1023. Asambleja e Ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative, si dhe të transferojë selinë e Shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3: KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4: OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Kompania do të fokusohet në tregtimin e mineraleve me qëllim ofrimin e materialeve të cilësisë së lartë për industrinë. Aktivitetet do të përfshijnë blerjen dhe shitjen e këtyre materialeve nga furnizues të besueshëm, si dhe ofrimin e shërbimeve të përpunimit, përfshirë prerjen dhe formësimin sipas kërkesave të klientëve.

Kompania do të ofrojë një gamë të gjerë produktesh metalike, duke përfshirë forma të ndryshme të arit, bakrit dhe çelikut, dhe do të fokusohet në sigurimin e cilësisë së lartë dhe përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Aktiviteti ynë përfshin blerjen, magazinimin dhe shpërndarjen e këtyre materialeve në tregun lokal dhe ndërkombëtar.

NENI 5: KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues, në vlerën 1,000,000 Lek (Një milion lekë), dhe përbëhet nga 3 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Nevzad Osmani** zotëron 1 kuota, me 33% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 330,000 Lek.
- **Z. Adriatik Mino** zotëron 1 kuota, me 33% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 330,000 Lek.
- **Z. Lavdrim Tufa** zotëron 1 kuota, me 34% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 340,000 Lek.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, të marra me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6: ORGANET E SHOQËRISË

Organet e Shoqërisë përbëhen nga Asambleja e Ortakëve dhe Organi Administrativ.

- **Asambleja e Ortakëve** është organi vendimmarrës i Shoqërisë, e cila vepron në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- **Organi i vetëm administrativ** i Shoqërisë është Administratori i vetëm, Z. Adriatik Mino, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7: LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8: DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqip dhe anglisht.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe u nënshkrua nga Ortakët themelues të Shoqërisë, duke autorizuar Z. Adriatik Mino, mbajtës i Passaportes me nr. BA2802201, për të kryer të gjitha


veprimet e nevojshme për regjistrimin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)
në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Nevzad Osmani



Z. Adriatik Mino



Z. Lavdrim Tufa

